



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 2, datë 29.01.2020

PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË, QË DO TË
TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR
PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO, QË
DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’, Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar, Ligji Nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M Nr. 955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike” i ndryshuar, të Udhëzimeve të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.3,4,5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok Ndihmën Ekonomike deri në 6%”, i ndryshuar, VKB nr.647, datë 23.12.2019 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2020 si dhe Buxhetin Afat-Mesëm 2020-2022”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendës Kryetarit Bashkisë z. Zhuljen Varfaj, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor si më poshtë vijon:
 - A. *Për rastet e trajtimit me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar, përfituese të këtij fondi do të jenë:*
 - Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
 - Familja përpara se të perzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht nga administratori shoqëror.
 - Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

- Rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.

B. *Për rastet e trajtimit me fonde të pushtetit vendor, përfituese të këtij fondi do të jenë:*

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
 - Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
 - Rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
 - Familjet me kryefamiljare gra, (të veja, të divorcuara), me të paktën një fëmijë, që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
 - Familjet të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, por që kanë probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin, etj), të cilët kanë vështirësi punësimi.
 - Familjet rome, të cilat kanë problem me regjistrimin dhe transferimin.
 - Familjet me një anëtar, që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftueshme.
2. Masa e ndihmës ekonomike për çdo familje do të përllogaritet sipas Udhëzimit Nr.4, datë 17.02.2017 “Për përllogaritjen e përfitimit të Ndihmës Ekonomike”.
 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social në varësi të Bashkisë Durrës.
 4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore“).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.01.2020